

Vendim nr. 67 datë 05.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 05.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5(S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SOSE BUÇPAPAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 69, datë 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. 43, datë 04.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. 706, datë 12.07.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-1594, datë 12.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës të Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” 132, 134, pika 1, shkronja “i”, 137, 140, pika 1, shkronja “a”, 142, pika 1, 148 pika 1 dhe 148/b, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Nenet 1, 6, 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Sose Buçpapaj ka ushtruar detyrën e inspektore së ushqimit pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), Kukës, konkretisht inspektore e ushqimit për rrethin e Tropojës. Në datën 24.12.2014 ajo ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ndaj kolegëve të saj A.Z., S.R., F.I. dhe H.D., duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 2, i Kodit Penal (KP), me pretendimin se këta shtetas kanë falsifikuar të dhënat e procesverbaleve të inspektimit të disa subjekteve të kontrolluara më parë nga ajo si inspektore, të cilat në vijim janë konstatuar si shkelje nga auditi. Gjithashtu, kundrejt saj është hartuar një peticion nga disa subjekte tregtare të rrethit Tropojë, të cilët ankoheshin se kërkuesja kishte marrëdhënie shumë të dobëta komunikimi, etikë të ulët profesionale dhe, si e tillë, është bërë e padëshirueshme në marrëdhënie me bizneset. Sipas kërkueses, peticioni është hartuar nga kolegët e saj me qëllim largimin e saj nga puna. Po kështu, A.Z., i ka marrë bllokun e gjobave pa mbajtur procesverbal përkatës për dorëzimin e tij sipas rregullave, me argumentin se ishte ndërruar formati i blloqeve të gjobave dhe duhej dorëzuar, dhe se procesverbali ekzistues për këtë qëllim nuk ishte nënshkruar prej saj. Për rrjedhojë, duke pasur një peticion të hartuar nga bizneset për ankesë ndaj saj dhe procesverbal me të dhëna të falsifikuara në disfavor të saj, mbi bazën e rezultatit të auditimit të punës, AKU-ja, Kukës ka vendosur largimin e saj nga puna.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka shpallur moskompetencën tokësore dhe ia ka kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Në këtë proces janë sekuestruar aktet, procesverbalet e gjobave dhe inspektimet e kryera nga kërkuesja, për të cilat ajo ka dyshime se ka ndërhyrje, fshirje dhe mbivendosje shkrimesh me qëllim ndryshimin e përmbajtjes së tyre, peticioni i subjekteve tregtare, të cilat kishin ankesa ndaj kërkueses si inspektore e ushqimit për atë rreth, si dhe procesverbali për dorëzimin e blloqeve të gjobave, për të cilin ajo ka deklaruar se nuk ishte nënshkruar prej saj.

3. Gjatë hetimit paraprak janë kryer ekspertime teknike, grafike të shkrimeve dhe nënshkrimeve në dokumentet e sipërcituara. Në përfundim të hetimeve prokuroria ka dalë në përfundimin se shtetasit A.Z., S.R., F.I. dhe H.D. kanë konsumuar veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i KP-së. Qëllimi i këtij falsifikimi ka qenë dëmtimi i kallëzueses me synim largimin e saj nga puna, si dhe paraqitja e saj si person i paaftë për kryerjen e detyrës. Në vijim, prokuroria ia ka përcjellë çështjen për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, së bashku me dosjen hetimore.

4. Në kohën që në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë po shqyrtohej çështja penale në ngarkim të të pandehurve për sa më sipër, në datën 03.10.2016 kërkuësja ka paraqitur pranë kësaj gjykate padi civile në procesin penal me objekt: “Detyrimin e të paditurve dhe të subjektit juridik AKU Kukës të rivendosë të gjitha të drejtat e paditëses, të cenuara nga akti i paligjshëm nga dita e pushimit nga puna deri në ditën e rivendosjes në ish detyrën e saj si inspektore pranë këtij subjekti. Detyrimin e të paditurve të paguajnë në favor të paditëses dëmshpërblimin material që përbëhet nga paga dhe ndryshimet e saj pas largimit nga puna, fitimin e munguar për të gjithë periudhën, interesin bankar mbi të gjithë shumën e papaguar, inflacionin zyrtar si dhe të paguajë sigurimet shoqërore të paditëses për të gjithë periudhën deri në ditën e kthimit të saj në punën e mëparshme. Detyrimin e palës së paditur të paguaje në favor të palës paditëse dëmshpërblimin moral në vlerën e 3 000 000 lekë. Shpenzimet gjyqësore dhe çdo shpenzim tjetër gjatë procesit gjyqësor në ngarkim të palës së paditur. Publikimin në media të vendimit përfundimtar të gjykatës. Sigurimin e padisë civile, nëpërmjet sequestrimit të pasurisë dhe të paditurit civil AKU Kukës në masën që i përket vlerës së të gjithë dëmshpërblimeve të kërkuara në objektin e padisë”. Në seancën e parë gjyqësore, në datën 06.10.2016, është vlerësuar nga gjyqtari se për padinë civile gjykata do të shprehej në seancën pasardhëse.

5. Kërkuësja në datën 07.10.2016 ka paraqitur, nëpërmjet postës, kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A.H. i cili ishte shortuar për shqyrtimin e çështjes. Ajo ka pretenduar se dy prej të pandehurve kanë lidhje krushqie dhe familjare me të. Kjo kërkesë nuk është regjistruar në protokollin e gjykatës dhe, për rrjedhojë, nuk është shqyrtuar. Në lidhje me të kërkuësja ka filluar një proces tjetër penal.

6. Në seancën e dytë gjyqësore, në datën 21.10.2016, nga ana e mbrojtësit të të pandehurve është paraqitur kërkesë për veçimin e padisë civile nga ajo penale dhe dërgimin e saj në gjykatën civile, me pretendimin se gjykimi i padisë civile vështirësonte procesin penal. Gjykata, bazuar në kërkesën e të pandehurve, pasi ka marrë edhe mendimin e prokurorit, ka vendosur veçimin e padisë civile me arsyetimin se vështirësonte dhe zvarriste procesin penal, pasi, në cilësinë e palës së paditur, përveç të pandehurve ishte edhe AKU-ja, Kukës.

7. Në datën 22.10.2016, përsëri nëpërmjet postës, kërkuesja ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A.H., kërkesë, e cila pas shortimit është marrë në shqyrtim nga një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate dhe në datën 01.11.2016 është vendosur mospranimi i saj.

8. Në vijim, për procesin penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. 43, datë 04.04.2017, ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurve A.Z., S.R., F.I. dhe H.D., pasi nuk u provua ekzistenca e të gjitha elementeve përbërëse të figurës së veprës penale, për rrjedhojë nuk u provua që këta të pandehur të kishin kryer veprën penale për të cilën akuzoheshin. Për petitionin/ankimin ndaj kërkueses, gjykata e rrethit ka pyetur, në cilësinë e dëshmitarëve, subjektet tregtare që rezultonin se kishin nënshkruar petitionin dhe që kanë pohuar se e kanë nënshkruar atë. Për sa u përket procesverbaleve për dorëzimin e blloqeve dhe procesverbaleve të tjera për të cilat organi i akuzës ka hetuar për ndërhyrje, fshirje dhe mbivendosje shkrimesh, gjykata ka arsyetuar se barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, atij i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga të pandehurit, pasi çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në lidhje me sa më lart, rezulton se është pyetur edhe kërkuesja. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

9. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 706, datë 12.07.2018, ka lënë në fuqi vendimin nr. 43, datë 04.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Ajo ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së rrethit është i bazuar në ligj dhe në prova, si i tillë duhet të lihet në fuqi. Bazuar në pikën 4 të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) “Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast, gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor”. Në vijim, gjykata e apelit ka përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor, duke

marrë në pyetje në seancë gjyqësore kërkuesen. Gjykata, referuar nenit 151 të KPP-së, ka vlerësuar se në asnjë prej provave të marra në fazën e hetimeve paraprake, por edhe nga provat e marra gjatë gjykimit të çështjes nuk krijohet bindja për fajësinë e të pandehurve. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1594, datë 12.10.2023, bazuar në nenet 432 dhe 441, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se Gjykata e Lartë nuk është gjykatë fakti, por është një gjykatë ligji që kontrollon vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm në drejtim të zbatimit të ligjit material ose procedural penal. Mënyra e vlerësimit të fakteve dhe provave, sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit Penal, është një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Kolegji Penal ka vlerësuar se Gjykata e Apelit Shkodër e ka argumentuar vendimmarrjen e saj në përputhje me parashikimet e nenit 383 të KPP-së. Vendimet e gjykatave të faktit janë të mirargumentuara, për sa i përket ekzistencës së faktit penal të rrethanave të çështjes në tërësi, vlerësimit dhe çmuarjes së provave të marra e të verifikuara, si dhe cilësimit ligjor të faktit penal për të cilin janë akuzuar të gjykuarit në këtë proces. Në përputhje me nenin 152 të KPP-së, gjykata e apelit ka referuar korrekt parimet e zbatuara në rastin konkret, duke u dhënë përgjigje të argumentuara shkaqeve të parashtruara nga prokurori në gjykatën e apelit, si dhe duke respektuar edhe kërkesat e nenit 427, pika 4, të KPP-së, në përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor për marrjen e dëshmisë së kallëzueses. Me të drejtë gjykatat e faktit kanë theksuar se barra e provës në procesin penal i takon prokurorisë. Në analizë të sa më sipër, Kolegji Penal ka vlerësuar se nuk rezulton që të ketë shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër.

11. Në datën 14.02.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

12. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 12.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi për shqyrtimin e çështjes është shortuar gjyqtari A.H., njëkohësisht edhe kryetar i kësaj gjykate, për të cilin ajo ka paraqitur dy kërkesa për përjashtimin e tij, për shkak se dy prej të pandehurve kanë lidhje krushqie dhe familjare me të. Kërkesa e parë është paraqitur në datën 07.10.2016, por ajo nuk është protokolluar dhe nuk ekziston si pjesë e dosjes. Kërkesa e dytë është paraqitur në datën 22.10.20216, por nuk është pranuar nga gjyqtari i cili e ka shqyrtuar atë. Për rrjedhojë, gjyqtari A.H. ka vijuar me veçimin e padisë civile nga procesi penal, ndonëse proceset kishin lidhje së bashku, ndërsa kërkuesja nëpërmjet këtij vendimi të gjyqtarit nuk është legjitimuar që të jetë palë në gjykimin penal. Kërkesa e dytë për përjashtim është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe jo nga gjykata e apelit, sipas parashikimeve të nenit 17, paragrafi 3, të KPP-së në fuqi. Gjyqtari i gjykatës së rrethit E.Ç., i cili ka zëvendësuar gjyqtarin A.H., pas transferimit të tij në një pozicion tjetër, ka dhënë vendimin për çështjen penale pa e filluar shqyrtimin gjyqësor nga fillimi, gjë e cila bie ndesh me procesin e rregullt ligjor.
- 12.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi ajo nuk është thirrur gjatë shqyrtimit në gjykatën e rrethit në cilësinë e viktimës së veprës penale, sipas neneve 9/a, 58 dhe 283 të KPP-së, por është pyetur meqenëse ishte prezente si dëshmitare pa fletëthirrje.
- 12.3. *Së drejtës së viktimës në procesin gjyqësor, së drejtës së cilësive juridike të kallëzueses së veprës penale*, pasi është marrë në cilësinë e dëshmitares dhe jo të viktimës në procesin penal të kallëzuar prej saj. Prokurori në koordinim me gjyqtarin, në kundërshtim me ligjin, në kërkesën që ka dërguar në gjykatë çështjen për gjykim, e ka renditur kërkuesen në listën e dëshmitarëve.
- 12.4. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur dhe ankimit efektiv*, pasi i është privuar e drejta e ankimit në të gjitha shkallët e gjykimi duke pasur statusin e dëshmitares. Gjykatat nuk kanë pranuar provat, ankimin, rekursin e kërkueses, pasi ajo në pozicionin e viktimës së veprës penale nuk parashikohet si palë në gjykim.
- 12.5. *Barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi duke mos marrë pjesë si viktimë në procesin gjyqësor, kërkuesja nuk ka mundur të mbrojë akuzën e bërë ndaj kolegëve.

Gjithashtu, edhe prokurori nuk e ka mbrojtur akuzën, duke bërë rolin e dëgjuesit gjatë procesit gjyqësor.

12.6. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi nga gjykata nuk është vlerësuar zgjatja e hetimeve nga prokuroria, konkretisht mbi 2 vjet, kjo me qëllim që të pandehurit të përfitonin nga dispozita e nenit 66 të KP-së.

12.7. *Sigurisë juridike*, për shkak të vendimmarrjeve të gabuara të gjykatave.

12.8. *Marrjes së provës në mënyrë të paligjshme*, pasi nga gjykatat janë marrë prova të pakërkuara nga kallëzuesja. Nga policia shkencore nuk janë sekuestruar procesverbalet sipas raportit të auditimit të punës së kërkueses, por procesverbale të rregullta, për të cilat ajo nuk kishte ushtruar kallëzim penal, në këtë mënyrë prokuroria ka ngritur akuzën pa e plotësuar me prova, me qëllim që t'i jepte shkak gjykatës për ta pushuar çështjen.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

15. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e saj si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur pafajësinë e disa shtetasve, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i KP-së, me pretendimin se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në disa aspekte, por pa përcaktuar ndonjë të drejtë substanciale të saj që lidhej drejtpërdrejt me këtë proces. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se neni 148, pika 1, i Kushtetutës parashikon: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit*”, që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria, organi i specializuar që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Për këtë arsye, Kolegji vëren se, në raste të tilla, gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje nga individi që ka pësuar dëm nga vepra penale, bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pa provuar cenimin e ndonjë të drejte substanciale të lidhur drejtpërdrejt me procesin penal.

17. Duke iu kthyer rastit konkret, kërkuesja ankohet në lidhje me dëmin e shkaktuar nga largimi nga detyra si inspektore ushqimi. Sipas saj, akti i largimit nga puna është bazuar në faktet që kanë qenë në themel të procesit penal dhe përgjatë këtij procesi është vërtetuar se disa prej akteve janë të falsifikuara. Në këto rrethana, Kolegji, pa vënë në dyshim se kërkuesja ka pësuar dëm nga falsifikimi i këtyre akteve, vlerëson se interesi substancial i saj lidhet me procesin gjyqësor administrativ ku po shqyrtohet padia civile. Ky proces është ende në shqyrtim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e procesit penal dhe interesat e saj mund t’i mbrojnë gjatë procesit administrativ, i cili, nga pikëpamja e efektivitetit, mund të riparojë të drejtën e cenuar, por

edhe në rast të një vendimi gjyqësor përfundimtar jo të favorshëm, ajo mund t'i drejtohet me ankim kushtetues individual kësaj Gjykate.

18. Për sa më sipër, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.